

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, BASHKIA TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, me objekt “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën vitet 2011, 2012 dhe 6-mujorti i I, viti 2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimet e Kryetarit të KLSH-së nr. 2, datë 06.01.2014 dhe nr. 6, datë 05.02.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 711/7, datë 13.01.2014 dhe nr. 711/10, datë 05.02.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar z. Lulzim Basha, Kryetar i Bashkisë, Tiranë dhe zj. Andia Pustina, Drejtor i Përgjithshëm i DPTTV, Bashkia Tiranë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Janë rekomanduar dy masa për inventarizimin e subjekteve dhe rakordimin e të dhënave midis sektorit të IT dhe atij të mbledhjes dhe përpunimit me qëllim plotësimin e dosjeve me të dhëna të domosdoshme si certifikatat e pronësisë për efekt të përlogaritjes së taksës për sipërfaqe të shfrytëzueshme si dhe për verifikimin në terren të të gjitha subjekteve me status në sistem “nuk gjendet vendndodhja” dhe, pas identifikimit të tyre, të përlogariten e vilen detyrimet për taksat vendore në shumën prej 1,228,500 lekë të evidentuar nga auditimi për 50 subjekte, kryesisht ambulant.

2. Nga DPTTV, Bashkia Tiranë, të ngrihet një grup pune për unifikimin e Rregullores së Brendshme të Institucionit, fillimin e procedurave për kalimin e administrimit të marrëdhënieve të punës sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe miratimin në KB, hartimin në bashkëpunim me Sektorin e IT të Rregullores së Përdorimit dhe Administrimit të programit informatik të menaxhimit të taksave dhe tarifave vendore, faqes në internet të DPTTV dhe shërbimit të e-mailit të brendshëm.

3. Nga DPTTV të merren masa për rritjen e bashkëpunimit midis Zyrës së Financës dhe Zyrës së Parkimit të Automjeteve dhe Kundërvajtjeve për disiplinimin e administrimit të biletave të parkimit si në fazën e planifikimit të nevojave vjetore ashtu dhe gjatë përdorimit të tyre si letra me vlerë jo vetëm në bazë të vlerës që mbartin por dhe si njësi fizike. Për rritjen e efikasitetit në këtë drejtim të shikohet mundësia e zëvendësimit të biletave të parkimit me sisteme dixhitale për rritjen e efikasitetit dhe ekonomikitetit duke qenë se ekzistojnë mundësitë nga pikëpamja e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

4. DPTTV të negociojë me përfaqësuesit e shoqërisë [REDAKTUAR] dhe të kërkojë, deri në rrugë gjyqësore, legjitimitetin e pronësisë mbi programin (software) të menaxhimit të taksave dhe tarifave vendore si dhe në drejtim të kërkesave për shtesa në procesin aplikativ (business process) dhe shërbime në kuadrin e mirëmbajtjes ose asistencës, të përcaktohen kosto të ndërhyrjeve dhe shërbimeve dhe të mos aplikohen kontrata mirëmbajtje në terma të përgjithshëm

por për çdo kërkesë të prokurohet blerja e shërbimit. Nga Sektori i Shërbimeve Informatike të merren masa që të krijohet mundësia, në bashkëpunim me shoqërinë [REDAKTUAR] për zgjerimin e hapësirës së auditueshme, objektiva dhe mekanizma për kontrollin e tyre sipas standardeve si COBIT ose të ngjashëm në fushën e administrimit të IT dhe programeve software.

Me qëllim që të rritet kontrolli në drejtim të administrimit material e financiar në ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve të njësisë është rekomanduar ngritje e një komisioni të kryesuar nga niveli drejtues i Institucionit për verifikimin fizik të shpenzimeve operative dhe të investimeve.

5. Të merren masa nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim dhe me marrëveshje me Shërbimin Përmbarimor që, në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndjekë në rrugën ligjore procedurat për vjeljen e detyrimeve, në shumën 17.3 miliard lekë, nga të cilat; për vitin 2011 në shumën 8.8 miliard lekë; për vitin 2012 në shumën 8.5 miliard lekë.

6. Të merren masa nga DPTTV që të ushtrohet kontroll në agjentët tatimorë për llogaritjen e detyrimeve tatimore dhe nga Sektori i Verifikimit në Terren dhe Sektori i Kontrollit Tatimor dhe Analizës së Riskut, të hartohen plane pune vjetore dhe mujore të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme si dhe të kryhet në mënyrë të dokumentuar llogaritja e riskut për kryerjen e kontrolleve në terren.

7. Nga Komisioni i Faljes pran DPTTV të merren masa për përshpejtimin e procedurave të faljes së borxhit që plotëson kushtet e ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, duke rritur numrin e specialistëve të angazhuar me hedhjen e të dhënave në sistemin informatik.

8. Nga Drejtoria Operacionale, Sektori i Kontrollit dhe Menaxhimit të Riskut, të merren masa që:

-Të mos përfshihen në programet e kontrollit rivlerësimi i xhiros së subjekti duke u bazuar në normën mesatare të fitimit dhe specialistët e kontrollit të mos bazohen në këtë metodë alternative të vlerësimit të xhiros por, të mbështeten në përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 18.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, neni 72.

-Të përpilohet një rregullore apo dokument standard për përzgjedhjen me risk të subjekteve për kontroll në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920 dt. 18.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, neni 80 “Kontrolli tatimor” , pika 4.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga DPTTV, Bashkia Tiranë, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën 17,170,016 lekë, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Vlera prej 1,271,000 lekë, nga 16 subjekte sipas aneksit nr. 4; vlera prej 279,740 lekë, nga 6 subjekte të biznesit të vogël, sipas aneksit 6; vlera prej 1,597,870 lekë nga 25 subjekte sipas

faqeve 94 – 97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit; vlera prej 3,632,045 lekë nga 15 subjekte sipas ankesit nr.1 dhe nga 35 subjekte sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit; vlera prej 7,446,000 lekë nga 396 subjekte që operojnë në fushën e ndërtimit, sipas aneksit nr. 3 bashkëlidhur RPA, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të taksave dhe tarifave vendore.

2. Vlera prej 864,000 lekë nga shoqëria [REDAKTUAR] për likuidim të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe asistencës për programin e menaxhimit të taksave dhe tarifave vendore në fillim të vitit 2011 sipas urdhërshpenzimeve nr. 5 dhe nr. 11, datë 18.01.2011, në mënyrë të kundërligjshme pasi programi është brenda afatit të garancisë, data 24.6.2011.

3. Vlera prej 118,600 lekë nga [REDAKTUAR], me detyrë ish-shofer; vlera prej 138,160 lekë nga [REDAKTUAR], me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm dhe [REDAKTUAR] me detyrë ish-punonjës i shërbimit; vlera prej 430,581 lekë nga [REDAKTUAR], me detyrë punonjës i shërbimit, [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës dhe [REDAKTUAR] me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Administratës dhe Shërbimeve, për karburant të tërhequr nga magazina, pa vërtetuar kryerjen e shpenzimit.

4. Vlera prej 168,000 lekë nga [REDAKTUAR] me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Informatike dhe subjekti fizik [REDAKTUAR]; vlera prej 189,000 lekë nga subjekti [REDAKTUAR]; vlera prej 159,900 lekë nga subjekti [REDAKTUAR]; vlera prej 398,120 lekë nga subjekti [REDAKTUAR]; vlera prej 477,000 lekë nga subjekti [REDAKTUAR], për likuidim të shpenzimeve për shërbime dhe punë të pakryera, sipas përcaktimeve në kontratat e lidhura me institucionin dhe në procedurat e blerjes me vlerë të vogël.

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 141 dhe neni 153 pika 1, 2 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe kontratës individuale të punës, t’i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të DPTTV, Bashkia Tiranë, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore nga vërejtje, kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët deri në zgjidhje të kontratës së punës për: 1- Z. [REDAKTUAR] me detyrë, Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit të Brendshëm dhe Investigimit në cilësinë e ish-Përgjegjësi të Sektorit të Verifikimit në Terren, për mungesë përgjegjshmërie në drejtimin e sektorit ku janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore në kuadrin e zbatimit të masave shtrënguese si pjesë e veprimtarisë për mbledhjen e borxhit tatimor gjatë vitit 2011 në drejtim të përpilimit dhe ekzekutimit të urdhër sekuestro për mallra e materiale të personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe rezultojnë debitor ndaj administratës; 2- Zj. [REDAKTUAR], me detyrë, Përgjegjës i Sektorit të Financës për keq menaxhim dhe keq administrim të sektorit në drejtim të procedurave të prokurimit me blerje me vlerë të vogël dhe likuidimit të shpenzimeve të paargumentuara.

II. Mbështetur në nenin 141, 153, 201 dhe 202 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe kontratës individuale të punës, nenet 8 dhe 9, Drejtori i Përgjithshëm i DPTTV, Bashkia Tiranë, të vlerësojë të metat e mangësitë e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore ose

administrative sipas shkallës së përgjegjësive për 35 punonjësit e atakuar në RP të Auditimit të cituar në rekomandime dhe, për punonjësit e tjerë të atakuar në RPA që nuk janë përfshirë në rekomandime, të analizohet shkalla e përgjegjësive dhe të reflektohet në vlerësimin vjetor të punës individuale.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenin 201 dhe neni 202 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, dhe kontratës individuale të punës, neni 9 “Gjobat”, t’i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të DPTTV, Bashkia Tiranë, që të fillojë procedura për të vendosur gjobë për 5 punonjës: 1-Zj. ■■■■■, me detyrë Përgjegjës i Administratës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve për keq menaxhim dhe keq administrim të sektorit në procesin e largimeve nga puna në mënyrë të padrejtë në 6-mujorin e II-të 2011 dhe tremujorin e I-rë 2012; shpenzime karburanti të tërhequra nga sektori pa vërtetuar kryerjen e shërbimit që lidhet më të si dhe për punë të pakryer dhe të likuiduar për së dyti operatorit ■■■■■; 2-Z. ■■■■■, me detyrë Specialist i Verifikimit në Terren; 3-Z. ■■■■■, me detyrë Specialist Sektorit i Shërbimeve Informatike, 4-Z. ■■■■■, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Informatike, 5-Zj. ■■■■■, me detyrë Juriste; në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Blerjet me Vlerë të Vogël, për realizimin e procedurave të blerjes me vlerë të vogël kryesisht shërbime, ku shpenzimi është i pa bazuar dhe likuidimi, pavarësisht se formalisht mbështetet në procedurat e blerjes me vlerë të vogël, është kryer pa vërtetuar realizimin e shërbimit në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu III, pika 2.

- Për të meta dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë për 10 ish-punonjësit e cituar në RPA, pasi nuk janë më në marrëdhënie pune me institucionin.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Albert Thoma, p/grupi, Artan Mirashi, Edvin Stefani, Hekuran Avdulaj dhe Marvin Karalli, më tej u shqyrtua nga Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

DPTTV, Bashkia Tiranë me shkresën nr. 2387/75, datë 06.02.2014 dhe me nr. 2387/77, datë 25.02.2014 ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve nga ku rezulton se janë vlerësuar dhe janë marrë masat përkatëse për zbatimin e masave organizative të propozuara, masave për shpërblim dëmi në shumën 17,170,016 lekë dhe masave disiplinore. Për masat administrative të rekomanduara janë pranuar dhe janë në proces të rivlerësimit të shkallës së përgjegjësive sipas RPA mbështetur në observacionet e disa punonjësve të cituar në rekomandime, të adresuara për Institucionin pas Raportit Përfundimtar të Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT